

VENDIM
Nr. 865, datë 10.12.2014

**PËR REDUKTIMIN DHE STABILIZIMIN E SHKARKIMEVE TË GAZEVE SERRË
TË FLUORINUARA¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objektivi i këtij vendimi është të mbrojë mjedisin nëpërmjet reduktimit të shkarkimeve të gazeve serrë të fluorinuara.

2. Ky vendim përcakton rregullat dhe procedurat lidhur me:

a) parandalimin, kufizimin, përdorimin, rikuperimin dhe shkatërrimin e gazeve serrë të fluorinuara dhe masat që lidhen me to;

b) kushtet për hedhjen në treg të produkteve dhe pajisjeve specifike që përmbajnë ose funksionimi i të cilave bazohet në gazet serrë të fluorinuara;

c) kushtet për përdorimet specifike të gazeve serrë të fluorinuara.

3. Aneksat, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, janë:

a) Aneksi I: lista e gazeve serrë të fluorinuara, referuar në pikën 4.5, të kreut I;

b) Aneksi II: lista e gazeve të tjera serrë të fluorinuara për të cilat raportohet në përputhje me kreun V;

c) Aneksi III: ndalimet e vendosjes në treg, referuar kreut IV;

ç) Aneksi IV: metodat e llogaritjes së potencialit të ngrohjes globale të një përzierjeje;

d) Aneksi V: formati i raportimit të gazeve serrë të fluorinuara, referuar kreut V;

dh) Aneksi VI: shpeshtësia e kontrollit të pajisjeve, referuar pikës 2.4, të kreut II.

4. Për qëllim të këtij vendimi, termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

4.1 “Aerosol teknik”, një shpërndarës (bombul) aerosoli, e përdorur në mirëmbajtjen, riparimin, pastrimin, testimin, dezinfektimin dhe prodhimin e produkteve e të pajisjeve, instalimin e pajisjeve dhe për përdorime të tjera.

4.2 “Cikli organik rankine”, një cikël që përmban gaze serrë të fluorinuara të kondensueshme që transformojnë nxehtësinë nga një burim i nxehtë në energji për gjenerimin e energjisë elektrike apo energjisë mekanike.

4.3 “Çmontim”, nxjerrja nga përdorimi i një produkti apo i një pjese të pajisjes që përmban gaze serrë të fluorinuara.

4.4 “Feedstock/lëndë e parë”, çdo gaz serrë i fluorinuar ose një substancë e listuar në aneksin II, që i nënshtrohet transformimit kimik në një proces, gjatë të cilit ajo është transformuar plotësisht nga përbërja e saj origjinale dhe shkarkimet e saj janë të papërfillshme.

4.5 “Gaze serrë të fluorinuara”, në vijim “gazet-F” janë hidrofluorokarbonet (HFCs), perfluorokarbonet (PFCs), heksafluori i squfurit (SF₆) dhe gaze të tjera serrë që përmbajnë fluor, të listuara në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi, ose përzierjet që përmbajnë ndonjë prej këtyre substancave.

4.6 “Hidrofluorokarbon” ose “HFCs”, substancat e listuara në seksionin 1 të aneksit I,

¹Ky vendim përafron pjesërisht rregulloren e Këshillit dhe Parlamentit Evropian (EC) nr.EC/517/2014, e datës 16 prill 2014 “Mbi gazet serrë të fluorinuara” që shfuqizon rregulloren (EC) nr.842/2006.

bashkëlidhur këtij vendimi, ose përzierjet që përmbajnë ndonjë prej këtyre substancave.

4.7 “Heksafluorid i squfurit ose “SF₆”, substanca e listuar në seksionin 3 të aneksit I ose përzierjet që përmbajnë këtë substancë.

4.8 “Instalim”, bashkimi i dy ose më shumë pjesëve të pajisjeve apo qarqeve që përmbajnë ose që janë të projektuara të përmbajnë gaze serrë të fluorinuara, me synimin për të montuar një sistem në vendin ku do të operohet, që përfshin edhe grumbullimin e gazit të përçuesve të një sistemi për të plotësuar një qark pa marrë parasysh nevojën për të ngarkuar sistemin mbas montimit.

4.9 “Kamion frigoriferik”, një mjet motorik me një masë prej më shumë se 3,5 tonë që është projektuar dhe ndërtuar kryesisht për të transportuar mallra dhe është i pajisur me një njësi frigoriferike.

4.10 “Kontejner”, një produkt i cili është projektuar kryesisht për transportimin dhe ruajtjen e gazeve serrë të fluorinuara.

4.11 “Kontejner pa rimbushje”, një kontejner i cili nuk mund të rimbushet pa u përshtatur për këtë qëllim ose është vendosur në treg pa parashikuar rikthimin apo rimbushjen e tij.

4.12 “Kutia e shpejtësisë elektrike”, ndryshimi i pozicionit të pajisjeve dhe kombinimit të tyre me pajisjet e kontrollit, matjes, pajisjet mbrojtëse dhe rregulluese dhe montimi i mjeteve dhe pajisjeve të tilla të shoqëruara me ndërldhjet, aksesoret, strukturat mbështetëse dhe mbyllëse, të destinuara për përdorim në lidhje me gjenerimin, transmetimin, shpërndarjen dhe transformimin e energjisë elektrike.

4.13 “Mirëmbajtje ose servis”, të gjitha aktivitetet, me përjashtim të rikuperimit dhe kontrollit të rrjedhjes, që përfshin ndarjen në qarqe, të cilat përmbajnë ose janë të projektuara të përmbajnë gaze serrë të fluorinuara, në veçanti furnizimi i sistemit me gaze serrë të fluorinuara, duke hequr një ose më shumë pjesë të qarkut a pajisjes, duke ribashkuar dy ose më shumë pjesë të qarkut ose të pajisjeve, si dhe riparimi i rrjedhjeve.

4.14 “Operator”, një person fizik ose juridik të cilit i është deleguar fuqia për funksionet teknike të produkteve dhe pajisjeve që mbulohen nga ky vendim.

4.15 “Pajisje e palëvizshme”, një pajisje që nuk lëviz gjatë funksionimit dhe përfshin pajisje të lëvizshme të dhomave të ajrit të kondicionuar.

4.16 “Pajisje e lëvizshme”, një pajisje në lëvizje gjatë operimit.

4.17 “Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri”, pajisjet dhe sistemet e përdorura në parandalimin e zjarreve apo pajisjet e shuarjes me presion përfshirë fikëset e zjarrit.

4.18 “Pajisje ushtarake”, armët, municionet dhe materialet e luftës të destinuara posaçërisht për qëllime ushtarake, që janë të nevojshme për mbrojtjen e interesave thelbësore të sigurisë së vendit.

4.19 “Paketa e sistemeve të centralizuara të ftohjes”, sisteme me dy ose më shumë kompresorë, të cilët operojnë në mënyrë paralele, të cilët janë të lidhur me një ose shumë kondensorë të përbashkët dhe me një numër pajisjesh ftohëse, të tilla si: vitrinat, banakët frigoriferikë, ngrirësit ose dhomat frigoriferike të ruajtjes.

4.20 “Perfluorokarbon” ose “PFCs”, substancat e listuara në seksionin 2 të aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi, ose përzierjet që përmbajnë ndonjë prej këtyre substancave.

4.21 “Përdorim”, përdorimi i gazeve serrë të fluorinuara gjatë prodhimit, mirëmbajtjes ose shërbimit, duke përfshirë rimbushjen e produkteve dhe pajisjeve ose në procese të tjera që i referohen këtij vendimi.

4.22 “Përdorim tregtar”, përdorimi për magazinimin, ekspozimin ose servirjen e produkteve për shitje te përdoruesi i fundit, në shitje me pakicë dhe në shërbimet e ushqimit.

4.23 “Përzierje”, një fluid (gaz i lëngshëm), i përbërë nga dy ose më shumë substanca, ku të paktën njëra prej tyre është një substancë e listuar në aneksin I ose në aneksin II, bashkëlidhur këtij vendimi.

4.24 “Potencial i ngrohjes globale” ose “PNG”, potenciali i ngrohjes së klimës nga një gaz serrë i fluorinuar në raport me atë të dyoksidit të karbonit. Potenciali i ngrohjes globale (PNG) është llogaritur në terma të potencialit të ngrohjes së shkaktuar nga një kilogram gaz për një

periudhë 100-vjeçare, krahasuar me atë të shkaktuar nga një kilogram CO₂ për të njëjtën periudhë, sikurse përcaktohet në anekset I, II dhe IV ose në rastet e përzierjeve, e llogaritur në përputhje me përcaktimin në aneksin IV, bashkëlidhur këtij vendimi.

4.25 “Qarku primar i ftohjes së sistemeve kaskadë”, qarku primar në sistemet indirekte me temperaturë mesatare ku kombinimi i dy ose më shumë qarqeve të veçanta të ftohjes janë të lidhura në seri të tilla që qarku primar absorbon/thith nxehtësinë e kondensimit të një qarku sekondar për një temperaturë mesatare.

4.26 “Riciklim”, ripërdorimi i një gazi serrë të fluorinuar, i rikuperuar më parë nëpërmjet një procesi bazik pastrimi.

4.27 “Rigjenerim”, ripërpunimi i një gazi serrë të fluorinuar të rikuperuar, në mënyrë që të plotësojë një standard specifik performance të një substancë të pastër, duke marrë në konsideratë qëllimin e përdorimit të tij.

4.28 “Rikuperim”, mbledhja dhe ruajtja e gazeve serrë të fluorinuara nga produktet, përfshirë kontejnerët dhe pajisjet gjatë mirëmbajtjes ose shërbimit apo përpara asgjësimit të produkteve ose pajisjes.

4.29 “Riparim”, restaurimi i produkteve të dëmtuara ose që rrjedhin apo pajisjes që përmban apo funksionimi i së cilës mbështetet në gaze serrë të fluorinuara, përfshirë një pjesë që përmban ose që është projektuar të përmbajë gaze të tilla.

4.30 “Rimorkio frigoriferike”, një makinë që është projektuar dhe ndërtuar për t’u tërhequr nga një kamion ose një traktor, kryesisht për të kryer transportin e mallrave dhe është e pajisur me një njësi frigoriferike.

4.31 “Sipërmarrës”, çdo person fizik ose juridik që:

a) prodhon, përdor, rikuperon, mbledh, riciklon, rigjeneron ose shkatërron gazet serrë të fluorinuara;

b) importon apo eksporton gazet serrë të fluorinuara ose produktet dhe pajisjet që përmbajnë këto gaze;

c) vendos në treg gazet serrë të fluorinuara ose produkte dhe pajisje që përmbajnë ose funksionet e të cilave mbështeten mbi këto gaze;

ç) instalon, kryen shërbime, mirëmban, riparon, kontrollon për rrjedhje ose çmonton/heq nga përdorimi pajisjet që përmbajnë, apo funksionimi i të cilave mbështetet mbi gazet serrë të fluorinuara;

d) është operatori i pajisjeve që përmbajnë apo funksionimi i të cilave mbështetet mbi gazet serrë të fluorinuara;

dh) prodhon, importon, eksporton, vendos në treg ose shkatërron gazet e listuara në aneksin II;

e) vendos në treg produkte ose pajisje që përmbajnë gazet e listuara në aneksin II.

4.32 “Sistem i mbyllur hermetikisht”, një pajisje në të cilën të gjitha pjesët që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara janë të puthitura me saldim, ngjitje ose lidhje të ngjashme të përhershme, të cilat mund të përfshijnë valvula të mbuluara dhe porta shërbimi të mbuluara, që lejojnë riparim të duhur ose asgjësim dhe të cilat kanë një shkallë rrjedhjeje të testuar në më pak se 3 gramë në vit nën një presion me të paktën një çerek të presionit maksimal të lejueshëm.

4.33 “Sistemet e veçanta të ndara të ajrit të kondicionuar”, sistemet për dhomat me ajër të kondicionuar, të cilat përbëhen nga një njësi e jashtme dhe një njësi e brendshme të lidhura me tuba ftohjeje, të cilët kanë nevojë për instalimin në vendin e përdorimit.

4.34 “Sistemi i zbulimit të rrjedhjeve”, një pajisje mekanike, elektrike ose elektronike e kalibruar për të zbuluar rrjedhje të gazeve serrë të fluorinuara, e cila, kur i zbulon, sinjalizon operatorin.

4.35 “Substancë e virgjër”, një substancë e cila nuk ka qenë e përdorur më parë.

4.36 “Shkatërrim”, procesi, me anë të të cilit pothuajse të gjitha ose një pjesë e gazeve serrë të fluorinuara transformohen në mënyrë të përhershme ose zbërthehen në një ose më shumë substanca të qëndrueshme, të cilat nuk janë më gaze serrë të fluorinuara.

4.37 “Shkumë me një komponent”, një përbërje shkume që përmbahet në një aerosol të vetëm në gjendje të lëngshme, e reaguuar ose pjesërisht e reaguuar, dhe që zgjerohet dhe mpikset kur del

nga bombula me spraj.

4.38 “Ton të CO₂ ekuivalent”, një sasi e gazeve serrë, e shprehur si prodhimi i peshës në metrik ton të gazeve serrë me potencialin e ngrohjes së tyre globale.

4.39 “Vendosje në treg”, furnizimi ose bërja e disponueshme për herë të parë në treg, me ose pa pagesë, ose përdorimi i produktit për qëllime të veta të prodhuesit dhe përfshin edhe zhdoganimin për qarkullim në tregun shqiptar.

KREU II PARANDALIMI DHE KONTROLLI

1. Parandalimi i shkarkimeve të gazeve serrë të fluorinuara

1.1 Ndalohej lëshimi i qëllimshëm i gazeve serrë të fluorinuara në atmosferë.

1.2 Operatorët e pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara marrin masat teknike dhe ekonomike paraprake, nëpërmjet krijimit të regjimit të kontrollit të rrjedhjeve nga pajisjet sipas kërkesave të parashikuara në këtë vendim, për të parandaluar dhe minimizuar lëshimin e paqëllimshëm (“rrjedhjet”) të këtyre gazeve.

1.3 Kur ndodh një rrjedhje e gazeve serrë të fluorinuara, operatori duhet të marrë masa të menjëhershme për riparimin e pajisjes.

1.4 Kur pajisja kontrollohet për rrjedhje, sipas pikës 2.1 të këtij kreu, dhe pajisja është riparuar, operatori verifikon, brenda një muaji nga dita e riparimit, nëse riparimi ka qenë efektiv. Kontrolli dhe verifikimi bëhen nga një person fizik i certifikuar.

1.5 Personat fizikë që kryejnë detyrat e referuara në shkronjat “a” deri në “c”, të pikës 8.1, të këtij kreu, duhet të jenë të certifikuar në përputhje me pikën 8.3, të këtij kreu.

1.6 Operatorët duhet të garantojnë se sipërmarrësit e kontraktuar, që kryejnë instalimin, servisin, mirëmbajtjen, riparimin ose çmontimin e pajisjeve të listuara në shkronjat “a” deri “d”, të pikës 2.3, duhet të jenë të certifikuar në përputhje me pikën 8.5.

2. Kontrolli i rrjedhjeve

2.1 Operatorët e pajisjes, që përmban gaze serrë të fluorinuara në sasi prej 5 tonë CO₂ ekuivalente ose më shumë dhe që nuk përfshihen në shkuma, sigurojnë që pajisja është kontrolluar për rrjedhjet.

2.2 Nuk i nënshtrohen kontrollit të rrjedhjes sipas pikës 2.1:

a) pajisja hermetikisht e mbyllur që përmban gaze serrë të fluorinuara në sasi më të vogël se 10 tonë CO₂ ekuivalente, me kusht që të jetë etiketuar si e mbyllur hermetikisht;

b) kutia elektrike e shpejtësisë nëse plotëson një nga kushtet e mëposhtme:

i) Ka një normë të testimit të rrjedhjes prej më pak se 0,1% në vit të përcaktuar në specifikimet teknike të prodhuesit dhe është i etiketuar si e tillë;

ii) Është e pajisur me një pajisje monitorimi të presionit ose densitetit;

iii) Përmban më pak se 6 kg gaze serrë të fluorinuara.

2.3 Pika 2.1 zbatohet për operatorët e pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara, si më poshtë vijon:

a) Pajisje të palëvizshme ftohjeje;

b) Pajisje të palëvizshme të ajrit të kondicionuar;

c) Pompat e nxehtësisë të palëvizshme;

ç) Pajisjet e palëvizshme të mbrojtjes nga zjarri;

d) Njësitë ftohëse në kamionët dhe rimorkiot frigoriferike;

dh) Kutia elektrike e shpejtësisë (*electric switchgear*);

e) Cikle organike rankine.

Për sa u përket pajisjeve të përmendura në shkronjat “a” deri “d”, të kësaj pike, kontrollet do të kryhen nga persona fizikë të certifikuar në përputhje me rregullat e parashikuara në pikën 8, të këtij kreu.

2.4 Kontrollet e rrjedhjes, referuar pikës 2.1, kryen me shpeshtësinë e mëposhtme:

a) Për pajisje që përmban gazet serrë të fluorinuara në sasi prej 5 tonë CO₂ ekuivalente ose më

shumë, por më pak se 50 tonë CO₂ ekuivalente: të paktën çdo 12 (dymbëdhjetë) muaj; ose kur një sistem zbulimi i rrjedhjeve është instaluar, të paktën çdo 24 (njëzet e katër) muaj;

b) Për pajisje që përmban gazet serrë të fluorinuara në sasi prej 50 tonë CO₂ ekuivalente ose më shumë, por më pak se 500 tonë CO₂ ekuivalente: të paktën çdo 6 (gjashtë) muaj ose, kur një sistem zbulimi i rrjedhjeve është instaluar, të paktën çdo 12 (dymbëdhjetë) muaj;

c) Për pajisje që përmban gazet serrë të fluorinuara në sasi prej 500 tonë CO₂ ekuivalente ose më shumë: të paktën çdo 3 (tre) muaj ose kur një sistem zbulimi i rrjedhjeve është instaluar, të paktën çdo 6 (gjashtë) muaj.

Paraqitja tabelare e këtij procesi jepet në aneksin VI, bashkëlidhur këtij vendimi.

2.5 Detyrimet për kryerjen e kontrollit të rrjedhjeve sipas pikës 2.1 për pajisjet e mbrojtjes nga zjarri, referuar në shkronjën “ç”, të pikës 2.3, konsiderohen të plotësuara kur janë plotësuar dy kushtet e mëposhtme:

a) Regjimi ekzistues i inspektimit plotëson standardet ISO 14520 apo EN 15.004;

b) Pajisja e mbrojtjes nga zjarri është inspektuar sa herë që kërkohet sipas pikës 2.4.

2.6 Kërkesat dhe metodat standarde të kontrollit të rrjedhjeve të gazeve serrë të fluorinuara nga pajisjet e përmendura në pikën 2.3 miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për ekonominë.

3. Sistemi i zbulimit të rrjedhjeve

3.1 Operatorët e pajisjes së listuar në shkronjat “a” deri në “ç”, të pikës 2.3, që përmban gaze serrë të fluorinuara në sasi ekuivalente prej 500 tonë CO₂ ose më shumë, sigurojnë që pajisja është e pajisur me sistemin e zbulimit të rrjedhjeve, i cili sinjalizon operatorin ose kompaninë e shërbimit për çdo rrjedhje.

3.2 Operatorët e pajisjes së listuar në shkronjat “dh” dhe “e”, të pikës 2.3, që përmban gaze serrë të fluorinuara në sasi ekuivalente prej 500 tonë CO₂ ose më shumë të instaluar nga 1 janari 2020, sigurojnë që kjo pajisje është e pajisur me një sistem të zbulimit të rrjedhjeve, i cili sinjalizon operatorin ose kompaninë e shërbimit për ndonjë rrjedhje.

3.3 Operatorët e pajisjes së listuar në shkronjat “a” deri në “ç” dhe “e”, të pikës 2.3, të këtij kreu, që janë subjekt i pikave 3.1 dhe 3.2, kryejnë kontrollin të paktën një herë në çdo 12 (dymbëdhjetë) muaj të sistemeve të zbulimit të rrjedhjeve për të siguruar funksionimin e duhur të tyre.

3.4 Operatorët e pajisjes së listuar në shkronjën “dh”, të pikës 2.3, që janë subjekt i pikës 3.2, kryejnë kontrollin një herë në çdo 6 (gjashtë) vjet të sistemeve të zbulimit të rrjedhjeve për të siguruar funksionimin e duhur të tyre.

4. Mbajtja dhe ruajtja e të dhënave

4.1 Operatorët e pajisjes, për të cilën kërkohet kontrolli për rrjedhjet në përputhje me pikën 2.1, krijojnë dhe mbajnë të dhëna për çdo pjesë të kësaj pajisjeje, duke specifikuar informacionin e mëposhtëm:

a) Për sasinë dhe llojin e gazeve serrë të fluorinuara të instaluar;

b) Për sasinë e gazeve serrë të fluorinuara, që janë shtuar gjatë instalimit, mirëmbajtjes ose shërbimit ose për shkak të rrjedhjes;

c) Nëse sasinë e instaluar të gazeve serrë të fluorinuara janë ricikluar apo rigjeneruar, përfshirë emrin dhe adresën e fabrikës/sipërmarrësit të riciklimit ose të rigjenerimit dhe, kur është e mundur, numrin e certifikatës;

ç) Për sasinë e rikuperuar të gazeve serrë të fluorinuara;

d) Për gjenealitetet e sipërmarrësit, i cili ka instaluar, ka kryer shërbimet, mirëmbajtjen dhe, kur është e zbatueshme, ka riparuar apo ka nxjerrë jashtë përdorimit pajisjen, duke përfshirë, kur është e mundur, numrin e certifikatës së tij;

dh) Për datat e kryerjes dhe rezultatet e kontrolleve të kryera në bazë të pikave 2.1 deri 2.4;

e) Nëse pajisja është nxjerrë jashtë përdorimit, masat e ndërmarra për rikuperimin dhe shkatërrimin e gazeve serrë të fluorinuara.

4.2 Operatorët e përmendur në pikën 4.1 mbajnë të dhënat për të paktën pesë vjet.

4.3 Për qëllim të pikës 1.2, të kreut IV, sipërmarrësit, që furnizojnë me gaze serrë të

fluorinuara, duhet të mbajnë të dhënat përkatëse me informacionin e duhur për blerësit e gazeve serrë të fluorinuara, përfshirë edhe të dhënat për:

- a) numrin e faturave të blerësve;
- b) sasitë përkatëse të blera të gazeve serrë të fluorinuara.

4.4 Sipërmarrësit që kryejnë shërbimet e përmendura në shkronjën “d”, të pikës 4.1, për operatorët duhet të mbajnë kopjet e të dhënave për të paktën pesë vjet.

4.5 Format i ruajtjes të së dhënave të kontrollit nga rrjedhjet për operatorët sipas kërkesave të pikës 4.1 dhe për sipërmarrësit sipas kërkesave të pikës 4.3 miratohet me urdhër të ministrit.

4.6 Të dhënat e përmendura në pikën 4.1 për operatorët dhe të dhënat për sipërmarrësit që furnizojnë me gaze serrë të fluorinuara vihen në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me kërkesë të saj. Nëse të dhënat e marra nga operatorët ose sipërmarrësit përmbajnë informacion mjedisor, Agjencia Kombëtare e Mjedisit i vë këto të dhëna në dispozicion të publikut, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Shkarkimet e gazeve serrë të fluorinuara në lidhje me prodhimin

5.1 Prodhuesit e komponimeve të fluorinuara marrin të gjitha masat e nevojshme për të kufizuar sa më shumë të jetë e mundur shkarkimet e gazeve serrë të fluorinuara gjatë prodhimit, transportit dhe magazinimit, si edhe në rastet kur gazet serrë të fluorinuara janë prodhuar si nënprodukte.

5.2 Pa rënë ndesh me pikën 1.1, të kreut IV, vendosja në treg e gazeve serrë të fluorinuara dhe gazeve të listuara në aneksin II ndalohej kur prodhuesit ose importuesit nuk kanë dokumentin ligjor që dëshmon kohën e vendosjes në treg dhe kur vërtetojnë se trifluorometani i prodhuar si një nënprodukt gjatë procesit të prodhimit, përfshirë prodhimin e lëndëve të para për prodhimin e tyre, është shkatërruar ose rikuperuar për përdorim të mëvonshëm, në përputhje me teknikat më të mira të disponueshme.

5.3 Kjo kërkesë do të zbatohet nga 11 qershori 2019.

6. Rikuperimi

6.1 Operatorët e pajisjeve të palëvizshme ose të njërive ftohëse (frigoriferike) të kamionëve dhe rimorkiove frigoriferike, që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara që nuk gjenden në shkuma, kryejnë rikuperimin e gazeve nëpërmjet personave fizikë që zotërojnë certifikatën përkatëse në përputhje me pikën 8, të këtij kreu, në mënyrë që këto gaze të riciklohen, të rigjenerohen ose të shkatërrohen.

Këto detyrime zbatohen për operatorët e pajisjeve të mëposhtme:

- a) Qarqet ftohëse të frigoriferëve të palëvizshëm, të pajisjeve stacionare me ajër të kondicionuar dhe pajisjeve stacionare të pompave të nxehtësisë;
- b) Qarqet ftohëse të njërive frigoriferike të kamionëve dhe trajlerëve frigoriferikë;
- c) Pajisjet stacionare (fikse) që përmbajnë tretës me bazë gaze serrë të fluorinuara;
- ç) Pajisjet stacionare (fikse) për mbrojtjen nga zjarri;
- d) Kutitë e shpejtësisë të stacioneve elektrike me tension të lartë.

6.2 Sipërmarrësi që përdor një kontejner që përmban gaze serrë të fluorinuara, përpara asgjësimit të tij merr masa për rikuperimin e gazeve të mbetura për të garantuar më tej riciklimin, rigjenerimin ose shkatërrimin e tyre.

6.3 Operatorët e produkteve dhe pajisjeve që nuk listohen në pikën 6.1, përfshirë pajisjet e lëvizshme që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara, marrin masa për rikuperimin e gazeve, në bazë të teknikave më të mira të disponueshme nga personat e duhur fizikë të kualifikuar, në mënyrë që ato të riciklohen, të rigjenerohen ose të shkatërrohen.

7. Skemat e përgjegjësisë të prodhuesit

7.1 Prodhuesi i gazeve serrë të fluorinuara apo/ose palët e treta që veprojnë në emër të tyre marrin masa që të financojnë të gjitha kostot që rrjedhin për ngritjen dhe funksionimin e skemës së rikuperimit, riciklimit, rigjenerimit apo shkatërrimit të gazeve serrë të fluorinuara, individualisht apo në bashkëpunim ndërmjet tyre, brenda një afati prej 5 (pesë) vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

7.2 Prodhuesit e pajisjeve dhe produkteve të gazeve serrë të fluorinuara ose palët e treta që veprojnë në emër të tyre:

a) sigurojnë që skema e rikuperimit, riciklimit, rigjenerimit apo shkatërrimit të gazeve serrë të fluorinuara realizohet nga persona fizikë apo sipërmarrje që zotërojnë certifikatën përkatëse në përputhje me pikën 8, të këtij kreu;

b) informojnë përdoruesit përfundimtarë dhe u japin mundësi të dorëzojnë në pika të afërta grumbullimi lehtësisht të aksesueshme prej tyre, siç janë pikat e shitjes së pajisjeve dhe produkteve përkatëse.

8. Trajnimi dhe certifikimi

8.1 Kërkesat minimale për programet e trajnimit, dëshmime të trajnimeve për personat fizikë, certifikimit për personat fizikë dhe sipërmarrësit, si edhe sistemi i vlerësimit të tyre miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për mjedisin, ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për tregtinë. Trajnimit u nënshtrohen personat fizikë që kryejnë detyrat e mëposhtme:

a) Instalimin, servisin, mirëmbajtjen, riparimin ose nxjerrjen nga përdorimi të pajisjeve të listuara në shkronjat “a” deri “dh”, të pikës 2.3, të këtij kreu;

b) Kontrollin e rrjedhjeve të pajisjeve të përmendura në shkronjat “a” deri “d”, të pikës 2.3, siç parashikohet në pikën 2.1;

c) Rikuperimin e gazeve serrë të fluorinuara, siç parashikohet në pikën 6.1.

Këto kërkesa minimale specifikojnë për secilin lloj të pajisjeve aftësitë dhe njohuritë e nevojshme praktike e teorike.

8.2 Programet e trajnimit të parashikuara në pikën 8.1 mbulojnë çështjet e mëposhtme:

a) Rregulloret e aplikueshme dhe standardet teknike;

b) Parandalimin e shkarkimeve;

c) Rikuperimin e gazeve serrë të fluorinuara;

ç) Trajtimin e sigurt të pajisjeve të llojit dhe madhësisë së përfshirë në certifikatë;

d) Informacion për teknologjitë përkatëse për të zëvendësuar ose për të zvogëluar përdorimin e gazeve serrë të fluorinuara dhe trajtimin e tyre të sigurt.

8.3 Certifikata për personat fizikë dhe sipërmarrësit, si dhe dëshmia e kryerjes së trajnimit për personat fizikë lëshohet nga “organi i akredituar certifikues i personelit”, pasi i nënshtrohen testimit teorik dhe praktik të njohurive, në përputhje me kërkesat e referuara në pikën 8.1, të këtij kreu. Sistemi i vlerësimit përcaktohet në udhëzimin e përbashkët referuar pikës 8.1, të këtij kreu.

8.4 Përfshihen nga testimi dhe pajisen me dëshmi të kryerjes së trajnimit personat fizikë, të cilët kryejnë detyrat e përcaktuara në pikën 8.1, vetëm për njësitë ftohëse në kamionët dhe rimorkiot frigoriferike sipas shkronjës “d”, të pikës 2.3, të këtij kreu.

8.5 Sipërmarrësit certifikohen vetëm nëse personeli i tij teknik (personat fizikë) është pajisur me certifikatë sipas përcaktimeve të pikës 8.3, të këtij kreu.

8.6 Deri në momentin e akreditimit si “organ/e certifikues/e të personelit”, certifikatat për personat fizikë dhe sipërmarrësit, si edhe dëshmia e kryerjes së trajnimit për personat fizikë lëshohen nga institucione publike ose jopublike të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për arsimin profesional dhe që plotësojnë minimalisht kushtet e mëposhtme:

a) Të kenë në dispozicion mjediset e duhura për trajnimin e personave fizikë;

b) Të kenë në dispozicion pajisjet demonstruese për trajnimin e personave fizikë;

c) Të kenë përvojë në fushën e trajnimeve referuar shkronjave “a”, “b” e “c”, të pikës 8.2, të këtij kreu, ose në fushën e mirëmbajtjes së pajisjeve të tjera elektrike dhe elektronike;

ç) Të kenë përvojë në fushën e testimit të njohurive teorike dhe praktike mbas përfundimit të programit të trajnimit nga personeli referuar shkronjave “a”, “b” e “c”, të pikës 8.2, të këtij kreu, ose në fushën e mirëmbajtjes së pajisjeve të tjera elektrike dhe elektronike;

d) Për kryerjen e çdo programi trajnimi, referuar shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 8.2, të ketë të punësuar ose të kontraktuar të paktën katër persona që kanë përvojë në fushën e edukimit, trajnimit ose planifikimit të pajisjeve për programet përkatëse të trajnimit.

8.7 Modeli i certifikatave dhe i dëshmisë miratohen me urdhër të ministrit.

8.8 Kostot e trajnimit të personave fizikë dhe sipërmarrësve mbulohen nga vetë personat fizikë për llogari të “organit të akredituar certifikues të personelit”.

8.9 Deri në krijimin e “organit të akredituar certifikues të personelit”, referuar në pikën 8.6, të këtij kreu, vlerësimi/testimi i njohurive teorike dhe praktike në përfundim të programit të trajnimit kryhet nga Komisioni i Vlerësimit, i cili ngrihet me urdhër të përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për arsimin dhe ka në përbërje:

- a) përfaqësues nga personeli i institucionit publik ose jopublik që ka kryer trajnimin;
- b) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, i cili mbulon çështjet e ndryshimeve klimatike;
- c) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, i cili mbulon çështjet e arsimit profesional.

8.10. Organi/et i/e akredituara, certifikues të personelit, sipas pikës 8.6, të këtij vendimi,:

a) ruan deri në 5 (pesë) vjet të dhënat e testeve teorike dhe praktike të kryera nga personat fizikë, si dhe rezultatin e përgjithshëm të testit;

b) pranon që personat fizikët t’i nënshtrohen testimit teorik dhe praktik, edhe pa kryer programin e trajnimit;

c) dërgon 1 (një) herë në muaj në Ministrinë e Mjedisit listën e personave fizikë që kanë kryer me sukses testimin teorik dhe praktik, e cila duhet të përmbajë emrin, mbiemrin, adresën, numrin e telefonit ose adresën e e-mail-it, kategorinë e pajisjes për të cilën ka kryer testimin, datën e testimit, si dhe numrin e regjistrimit të certifikatës;

ç) njofton Ministrinë e Mjedisit për vendin dhe datën e kryerjes së testimit, 1 muaj përpara kryerjes së tij.

8.11 Agjencia Kombëtare e Akreditimit dërgon në Ministrinë e Mjedisit listën e “organeve të akredituara certifikuese të personelit” për gazet e fluorinuara, si dhe përditësimin periodik të saj.

8.12 Ministria përgjegjëse për arsimin dërgon në Ministrinë e Mjedisit listën e institucioneve publike dhe jopublike të licencuara në fushën e pajisjeve elektrike dhe elektronike që mbulojnë edhe gazet serrë të fluorinuara.

8.13 Ministria e Mjedisit krijon dhe publikon regjistrin me të dhënat, për:

- a) certifikatat e lëshuara për personat fizikë dhe sipërmarrësit;
- b) dëshmitë e kryerjes së trajnimeve të lëshuara për personat fizikë;
- c) organin/et e/të akredituar/a certifikues/e të personelit”;
- ç) institucionet publike dhe jopublike të licencuara.

8.14 Modeli i regjistrit dhe mënyra e administrimit të tij miratohen me urdhër të ministrit.

KREU III

VENDOSJA NË TREG DHE KONTROLI I PËRDORIMIT

1. Kufizimet për vendosjen në treg

1.1 Afatet kohore të ndalimit të vendosjes në treg të produkteve dhe pajisjeve të listuara në tabelën e aneksit III, bashkëlidhur këtij vendimi, do të përcaktohen brenda vitit 2018, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për tregtinë.

1.2 Shitja dhe blerja e gazeve serrë të fluorinuara për qëllime të kryerjes së instalimit, shërbimeve, mirëmbajtjes ose riparimit të pajisjeve, që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara ose funksionimi i të cilave mbështetet mbi ato gaze, kryhet vetëm për personat fizikë ose juridikë të pajisur me certifikatë sipas pikës 8, të kreut II, të këtij vendimi. Për sipërmarrësit, që kryejnë vetëm transportin dhe shpërndarjen e gazeve serrë të fluorinuara, pajisja me certifikatë nuk është e detyrueshme.

1.3 Pajisjet e mbyllura jo hermetikisht të mbushura me gaze serrë të fluorinuara shiten për përdoruesit e fundit, vetëm kur ai dëshmon se instalimi i pajisjes do të kryhet nga një person fizik/sipërmarrës i certifikuar në përputhje me pikën 8, të kreut II, të këtij vendimi.

2. Kontrolli i përdorimit

2.1 Ndalohet përdorimi i hekzafluorit të squfurit:

a) në procesin e derdhjes së magnezit dhe në riciklimin e aliazheve të magnezit të derdhur. Për instalimet që përdorin një sasi të hekzafluorit të squfurit më pak se 850 kg në vit, në procesin e derdhjes së magnezit dhe në riciklimin e aliazheve të magnezit të derdhur, ky ndalim do të zbatohet nga 1 janari 2021;

b) në përmbushjen e gomave të makinave.

2.2 Afatet kohore për ndalimin e përdorimit të gazeve serrë të fluorinuara, me një potencial të ngrohjes globale prej 2 500 apo më shumë, për shërbimin ose mirëmbajtjen e pajisjeve të ftohjes me një masë mbushjeje prej 40 tonë CO₂ ekuivalente ose më shumë, do të përcaktohen brenda vitit 2019.

2.3 Përfshihen nga ndalimet pajisjet ushtarake ose pajisjet e destinuara për aplikimet e projektuara për ftohjen e produkteve nën temperaturën -50 °C.

2.4 Ndalimet e referuara në pikën 2.2, të këtij kreu, nuk zbatohen për kategoritë e mëposhtme të gazeve serrë të fluorinuara, deri në datën 1 janar 2030:

a) Gazet serrë të fluorinuara të rigjeneruara që kanë një potencial të ngrohjes globale prej 2500 ose më shumë, që përdoren për mirëmbajtjen ose shërbimin e pajisjeve ekzistuese ftohëse dhe të etiketuara në përputhje me pikën 3.6, të këtij kreu;

b) Gazet serrë të fluorinuara të ricikluara që kanë një potencial të ngrohjes globale prej 2500 ose më shumë, që përdoren për mirëmbajtjen ose shërbimin e pajisjeve ekzistuese ftohëse dhe që sigurojnë se janë rikuperuar nga pajisje të tilla. Gaze të tilla të ricikluara mund të përdoren vetëm nga sipërmarrësit të cilët kryejnë rikuperimin e tyre si pjesë e mirëmbajtjes ose shërbimit.

3. Etiketimi dhe informacioni për produktet dhe pajisjet

3.1 Produktet dhe pajisjet, që përmbajnë ose funksionimi i të cilave mbështetet mbi gazet serrë të fluorinuara, vendosen në treg vetëm nëse janë pajisur me etiketë. Kjo kërkesë zbatohet vetëm për:

a) Pajisjet ftohëse frigoriferike;

b) Pajisjet me ajër të kondicionuar;

c) Pompat e nxehtësisë;

ç) Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri;

d) Kutinë e shpejtësisë elektrike;

dh) Aerosolet që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara, me përjashtim të inhalatorëve me doza të përcaktuara për shpërndarjen e përbërësve farmaceutikë;

e) të gjithë kontejnerët e gazeve serrë të fluorinuara.

3.2 Etiketat e kërkuara, referuar pikës 3.1, të këtij kreu, duhet të tregojnë të dhënat e mëposhtme:

a) Një referencë që produkti ose pajisja përmban gaze serrë të fluorinuara ose që funksionimi i tyre mbështetet mbi gaze të tilla;

b) Emërtimi i pranuar nga industria për gazet serrë të fluorinuara në fjalë ose, nëse nuk ka përcaktim të tillë, vendosja e emrit kimik;

c) Nga 1 janari 2020, sasinë e shprehur në peshë dhe në CO₂ ekuivalente e gazeve serrë të fluorinuara, që përmbahen në produkt apo pajisje, ose sasinë e gazeve serrë të fluorinuara, për të cilën pajisja është projektuar, si edhe potencialin e ngrohjes globale të këtyre gazeve.

3.3 Etiketat e kërkuara sipas pikës 3.1, të këtij kreu, kur është e aplikueshme/zbatueshme duhet të tregojnë të dhënat e mëposhtme:

a) Një referencë që gazet serrë të fluorinuara përmbahen në pajisje hermetikisht të mbyllura;

b) Një referencë që kutia e shpejtësisë elektrike ka një normë të testimit për rrjedhje prej më pak se 0,1% në vit, të përcaktuar në specifikimet teknike të prodhuesit.

3.4 Etiketa duhet të jetë qartësisht e lexueshme, që nuk fshihet, në gjuhën shqipe dhe vendoset:

a) afër portave hyrëse ku kryhet mbushja ose rigjenerimi i gazeve-F;

b) në atë pjesë të produktit ose pajisjes që përmban gaze serrë të fluorinuara. Për sistemet e mbyllura hermetikisht, ato duhet të etiketohen si të tilla.

3.5 Shkumat dhe polyolet e parapërziera, që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara, do të vendosen në treg vetëm nëse gazet serrë të fluorinuara janë identifikuar me një etiketë duke përdorur emërtimin

e pranuar nga industria për gazet serrë të fluorinuara në fjalë ose, nëse nuk ka përcaktim të tillë vendoset emri kimik. Etiketa duhet të tregojë në mënyrë të qartë se shkuma ose polyolet e parapërziera përmbajnë gaze serrë të fluorinuara. Në rastin e shtresave të polisteroleve, ky informacion deklarohet në mënyrë të qartë dhe të pashlyeshme në shtresë në gjuhën shqipe.

3.6 Gazet serrë të fluorinuara të rigjeneruara apo të ricikluara duhet të etiketohen me një tregues se substanca është rigjeneruar ose ricikluar, dhe të shoqërohen me informacionin për numrin e serisë dhe emrin e adresën e fabrikës/sipërmarrësit që ka kryer rigjenerimin ose riciklimin.

3.7 Gazet serrë të fluorinuara, të vendosura në treg për shkatërrim, duhet të etiketohen me një tregues se përmbajtja e kontejnerit duhet vetëm të shkatërrohet.

3.8 Gazet serrë të fluorinuara, që vendosen në treg për eksport të drejtpërdrejtë, të etiketohen me një tregues që përmbajtja e kontejnerit të eksportohet menjëherë.

3.9 Gazet serrë të fluorinuara, të vendosura në treg për përdorim në pajisjet ushtarake, etiketohen me një tregues që përmbajtja e kontejnerit përdoret vetëm për atë qëllim.

3.10 Gazet serrë të fluorinuara, të vendosura në treg për gravurën e materialeve gjysmëpërçuese ose për pastrimin me avull kimikatesh të dhomave të depozitimit brenda sektorit të prodhimit të gjysmëpërçuesve, të etiketohen me një tregues se përmbajtja e kontejnerit mund të përdoret vetëm për këtë qëllim.

3.11 Gazet serrë të fluorinuara, të vendosura në treg për përdorim si lëndë e parë/feedstock, të etiketohen me një tregues se përmbajtja e kontejnerit mund të përdoret vetëm si lëndë e parë/feedstock.

3.12 Gazet serrë të fluorinuara, të vendosura në treg për prodhimin e inhalatorëve për thithjen e dozave të përcaktuara të ilaçeve, për furnizimin e përbërësve farmaceutikë, të etiketohen me një tregues se përmbajtja e kontejnerit të përdoret vetëm për atë qëllim.

3.13 Informacioni i përmendur në pikat 3.2 dhe 3.5, të këtij kreu, përfshihet në manualët udhëzuese për produktet dhe pajisjet në fjalë.

3.14 Në rastin e produkteve dhe pajisjeve, që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara me një potencial të ngrohjes globale prej 150 ose më shumë, ky informacion të përfshihet edhe në përshkrimet e përdorura për reklama.

3.15 Forma e etiketës dhe kërkesa shtesë për etiketimin e produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit, ministrit përgjegjës për tregtinë dhe ministrit përgjegjës për industrinë.

KREU IV RAPORTIMI

1. Raportimi për prodhimin, importin, eksportin përdorimin e lëndës së parë/feedstock dhe shkatërrimin e substancave të listuara në anekset I dhe II

1.1 Që prej 31 marsit 2018 dhe çdo vit pasues, çdo prodhues, importues dhe eksportues, që prodhon, importon ose eksporton 1 metrik ton ose 100 tonë CO₂ ekuivalent ose më shumë gaze serrë të fluorinuara dhe gazet e listuara në aneksin II, gjatë vitit pasardhës duhet të informojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për të dhënat e specifikuara në aneksin V për secilën nga ato substanca për atë vit kalendarik.

1.2 Që prej 31 marsit 2018 dhe çdo vit pasues, çdo sipërmarrës, që shkatërron 1 metrik ton ose 1000 tonë CO₂ ekuivalent ose më shumë gaze serrë të fluorinuara dhe gazet e listuara në aneksin II, gjatë vitit pasardhës duhet të informojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për të dhënat e specifikuara në aneksin V për secilën nga ato substanca për atë vit kalendarik.

1.3 Që prej 31 marsit 2018 dhe çdo vit pasues, çdo sipërmarrës, që përdor 1000 tonë CO₂ ekuivalent ose më shumë gaze serrë të fluorinuara si lëndë të parë/feedstock gjatë vitit pasardhës duhet të informojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për të dhënat e specifikuara në aneksin V për secilën nga ato substanca për atë vit kalendarik.

1.4 Që prej 31 marsit 2018 dhe çdo vit pasues, çdo sipërmarrës, që ka vendosur në treg 500

tonë CO₂ ekuivalent ose më shumë gaze serrë të fluorinuara dhe gazet e listuara në aneksin II që gjenden në produkte ose pajisje, gjatë vitit pasardhës duhet të informojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për të dhënat e specifikuara në aneksin V për secilën nga ato substanca për atë vit kalendarik.

2. Grumbullimi i të dhënave të shkarkimeve

2.1 Agjencia Kombëtare e Mjedisit ngre një bazë të dhënash në përputhje me të dhënat e ruajtura sipas pikës 4, të kreut II, për sektorët përkatës referuar në këtë vendim, me synim marrjen e të dhënave të shkarkimeve të gazeve serrë të fluorinuara.

2.2 Agjencia Kombëtare e Mjedisit përdor bazën e të dhënave referuar pikës 2.1, të kreut V, për hartimin e inventarit kombëtar të gazeve me efekt serrë.

KREU V INSPEKTIMI

1. Mospërmbushja e kërkesave të këtij vendimi, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas nenit 69, pika 1/b, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, për shkeljet, si më poshtë vijon:

a) Nga operatorët lidhur me:

i) lëshimin e qëllimshëm të gazeve serrë të fluorinuara në atmosferë gjatë instalimit, servisit, mirëmbajtjes, riparimit ose çmontimit të pajisjeve;

ii) lëshimin e qëllimshëm të gazeve serrë të fluorinuara në atmosferë gjatë rikuperimit, riciklimit dhe rigjenerimit të gazeve serrë të fluorinuara;

iii) moskryerjen e kontrollit për rrjedhje të pajisjeve të referuara në pikën 2.3, të kreut II, të këtij vendimi, nga persona të certifikuar;

iv) moskryerjen e kontrollit për rrjedhje të pajisjeve të referuara në pikën 2.3, të kreut II, të këtij vendimi, që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara në sasi prej 5 tonë CO₂ ekuivalente ose më shumë;

v) moskryerjen e kontrollit për rrjedhje të pajisjeve të referuara në pikën 2.3, të kreut II, me shpeshtësinë e përcaktuar në pikën 2.4, të kreut II, të këtij vendimi;

vi) mosplotësimin e kushteve të kontrollit të përcaktuara në pikën 2.5, të kreut II, të këtij vendimi, për pajisjet e palëvizshme të mbrojtjes nga zjarri;

vii) mospajisjen e pajisjeve të referuara në pikën 2.3, të kreut II, me sistemin e zbulimit të rrjedhjeve, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 3, të kreut II, të këtij vendimi;

viii) mosmbajtjen e të dhënave të specifikuara në pikën 4.1, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo pjesë të pajisjeve dhe mosruajtjen e tyre për të paktën 5 (pesë) vjet;

ix) mosvënien në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me kërkesë të saj, të të dhënave të specifikuara në pikën 4.1, të kreut II, të këtij vendimi;

x) moskryerjen e rikuperimit të gazeve serrë të fluorinuara nga pajisjet e palëvizshme ose njësitë ftohëse (frigoriferike) të kamionave dhe rimorkiove frigoriferikë, që listohen në pikën 6.1, të kreut II, të këtij vendimi, nëpërmjet personave fizikë që zotërojnë certifikatën përkatëse;

xi) moskryerjen e rikuperimit të gazeve serrë të fluorinuara, nga produktet dhe pajisjet që nuk listohen në pikën 6.1, të kreut II, të këtij vendimi, në bazë të teknikave më të mira të disponueshme, nga personat e duhur fizikë të kualifikuar.

b) Nga sipërmarrësit:

i) që kryejnë instalimin, servisin, mirëmbajtjen, riparimin ose çmontimin e pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara, me persona të pacertifikuar;

ii) për mosmbajtjen e të dhënave të specifikuara në pikën 4.1, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo pjesë të pajisjeve dhe mosruajtjen e tyre për të paktën 5 (pesë) vjet;

iii) për mosvënien në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me kërkesë të saj, të të dhënave të specifikuara në pikën 4.1, të kreut II, të këtij vendimi;

iv) për mosmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për të kufizuar shkarkimet e gazeve serrë të fluorinuara gjatë prodhimit, transportit dhe magazinimit, si dhe në rastet kur gazet serrë të

fluorinuara janë prodhuar si nënprodukte;

v) për vendosjen në treg të gazeve serrë të fluorinuara dhe gazeve të listuara në aneksin II, të këtij vendimi, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 5.2, të kreut II, të këtij vendimi;

vi) për mosmarrjen e masave për rikuperimin e gazeve të mbetura kur përdor një kontejner që përmban gaze serrë të fluorinuara, përpara asgjësimit të tij;

vii) për mosmarrjen e masave për finacimin e të gjitha kostove, që rrjedhin për ngritjen dhe funksionimin e skemës së rikuperimit, riciklimit, rigjenerimit apo shkatërrimit të gazeve serrë të fluorinuara, brenda 5 (pesë) vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

viii) për mosrealizimin e skemës së rikuperimit, riciklimit, rigjenerimit apo shkatërrimit të gazeve serrë të fluorinuara nga persona fizikë apo sipërmarrje që zotërojnë certifikatën përkatëse;

ix) për shitjen dhe blerjen e gazeve serrë të fluorinuara për qëllime të kryerjes së instalimit, shërbimeve, mirëmbajtjes ose riparimit të pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara ose funksionimi i të cilave mbështetet mbi ato gaze ndaj personave fizikë ose juridikë të papajisur me certifikatë;

x) për shitje të pajisjeve të mbyllura jo hermetikisht, të mbushura me gaze serrë të fluorinuara, për përdoruesit e fundit, kur ai nuk dëshmon se instalimi i pajisjes do të kryhet nga një person fizik/sipërmarrës i certifikuar;

xi) për përdorim të hekzafluorit të squfurit në procesin e derdhjes së magnezit dhe në riciklimin e aliazheve të magnezit të derdhur dhe për mbushjen e gomave të makinave;

xii) për vendosjen në treg të produkteve dhe pajisjeve të referuara në pikën 3.1, të kreut III, të këtij vendimi, të papajisura me etiketë;

xiii) për mosraportimin për prodhimin, importin, eksportin, përdorimin e lëndës së parë/feedstock dhe shkatërrimin e substancave të listuara në anekset I dhe II, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të kreut V, të këtij vendimi.

2. Autoriteti kompetent për inspektimin dhe ndëshkimin e kundërvajtjeve administrative, sipas pikës 1, është Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, përjashtuar nënndarjen “xii”, të shkronjës “b”, të pikës 1.

3. Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut në ministrinë përgjegjëse për tregtinë është autoriteti përgjegjës për inspektimin e etiketës së produkteve dhe pajisjeve të importuara apo të prodhuara në vend, që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara në përputhje me kërkesat e kreut III, pika 3, e ndëshkueshme sipas nënndarjes “xii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu.

4. Inspektorati Qendror Teknik, përgjegjës për sigurinë e pajisjeve dhe instalimeve elektrike dhe të pajisjeve nën presion, është autoriteti kompetent për kontrollin e pajisjeve të referuara në shkronjat “dh” e “e”, të pikës 2.3, të kreut II, të këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin që garanton sigurinë e punës së pajisjeve nën presion dhe sigurinë e punës së pajisjeve dhe të instalimeve elektrike.

5. Autoriteti doganor është autoriteti kompetent, për:

a) inspektimin e importit dhe eksportit të gazeve serrë të fluorinuara dhe produkteve ose pajisjeve që i përmbajnë ato;

b) raportimin, çdo datë 31 mars, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të të dhënave të ruajtura të vitit të mëparshëm kalendarik për importin dhe eksportin e gazeve serrë të fluorinuara dhe produktet që i përmbajnë ato, raportim i bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

c) moszhdoganimin për gazet e fluorinuara ose produktet që i përmbajnë ato nëse gjejnë shkelje të kërkesave të përcaktuara në kreun III, pikat 1, 2, 3;

ç) gazet apo produktet që nuk zhdoganohen për shkak të shkeljeve të kërkesave të përcaktuara në kreun III, pikat 1 e 2, e që kthehen mbrapsht në destinacionin nga kanë ardhur;

d) gazet apo produktet që nuk zhdoganohen për shkak të shkeljeve të kërkesave të përcaktuara në kreun III, pika 3, e që magazinohen deri në zbatimin e kërkesave të etiketimit.

Gjatë kryerjes së inspektimeve në përputhje me parashikimet e këtij vendimi, autoritetet

doganore mund të kërkojnë asistencën profesionale të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave.

KREU VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Inspektorati Qendror Teknik, Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1

GAZET E FLUORINUARA ME EFEKT SERRË TË REFERUARA NË PIKËN 4.5 TË KREUT I

Substanca				PNG (1) Potenciali i ngrohjes globale
Përcaktimi industrial	Emri kimik (Emri i përgjithshëm)	Formula kimike	Kodi tarifor	
Seksioni 1: Hydrofluorokarbonet (HFCs)				
HFC-23	trifluoromethane (fluoroform)	CHF ₃	2903.39.90	14 800
HFC-32	difluoromethane	CH ₂ F ₂	2903.39.90	675
HFC-41	fluoromethane (methyl fluoride)	CH ₃ F	2903.39.90	92
HFC-125	pentafluoroethane	CHF ₂ CF ₃	2903.39.90	3 500
HFC-134	1,1,2,2-tetrafluoroethane	CHF ₂ CHF ₂	2903.39.90	1 100
HFC-134a	1,1,1,2-tetrafluoroethane	CH ₂ FCF ₃	2903.39.90	1 430
HFC-143	1,1,2-trifluoroethane	CH ₂ FCHF ₂	2903.39.90	353
HFC-143a	1,1,1-trifluoroethane	CH ₃ CF ₃	2903.39.90	4 470
HFC-152	1,2-difluoroethane	CH ₂ FCH ₂ F	2903.39.90	53
HFC-152a	1,1-difluoroethane	CH ₃ CHF ₂	2903.39.90	124
HFC-161	fluoroethane (ethyl fluoride)	CH ₃ CH ₂ F	2903.39.90	12
HFC-227ea	1,1,1,2,3,3,3-heptafluoropropane	CF ₃ CHFCF ₃	2903.39.90	3 220
HFC-236cb	1,1,1,2,2,3-hexafluoropropane	CH ₂ FCF ₂ CF ₃	2903.39.90	1 340
HFC-236ea	1,1,1,2,3,3-hexafluoropropane	CHF ₂ CHFCF ₃	2903.39.90	1 370
HFC-236fa	1,1,1,3,3,3-hexafluoropropane	CF ₃ CH ₂ CF ₃	2903.39.90	9 810
HFC-245ca	1,1,2,2,3-pentafluoropropane	CH ₂ FCF ₂ CHF ₂	2903.39.90	693
HFC-245fa	1,1,1,3,3-pentafluoropropane	CHF ₂ CH ₂ CF ₃	2903.39.90	1 030
HFC-365 mfc	1,1,1,3,3-pentafluorobutane	CF ₃ CH ₂ CF ₂ CH ₃	2903.39.90	794
HFC-43-10 mee	1,1,1,2,2,3,4,5,5,5-decafluoropentane	CF ₃ CHFCHFCF ₂ CF ₃	2903.39.90	1 640
Seksioni 2: Perfluorokarbonet (PFCs)				
PFC-14	tetrafluoromethane	CF ₄	2903.39.90	7 390

	(perfluoromethane, carbon tetrafluoride)			
PFC-116	hexafluoroethane (perfluoroethane)	C ₂ F ₆	2903.39.90	12 200
PFC-218	octafluoropropane (perfluoropropane)	C ₃ F ₈	2903.39.90	8 830
PFC-3-1-10 (R-31-10)	decafluorobutane (perfluorobutane)	C ₄ F ₁₀	2903.39.90	8 860
PFC-4-1-12 (R-41-12)	dodecafluoropentane (perfluoropentane)	C ₅ F ₁₂	2903.39.90	9 160
PFC-5-1-14 (R-51-14)	tetradecafluorohexane (perfluorohexane)	C ₆ F ₁₄	2903.39.90	9 300
PFC-c-318	octafluorocyclobutane (perfluorocyclobutane)	c-C ₄ F ₈	2903.39.90	10 300
Seksioni 3: Komponente të tjera të perfluorinuara				
	sulphur hexafluoride	SF ₆	2903.39.90	22 800

(1) Bazuar në raportin e vlerësimit të katërt të miratuar nga Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike, përveç nëse tregohet ndryshe.

ANEKSI II

GAZE TË TJERA TË FLUORINUARA ME EFEKT SERRË SUBJEKT I RAPORTIMIT NË PËRPUTHJE ME KREUN IV

Substanca			PNG (1) Potenciali i ngrohjes globale
Emri i përgjithshëm/përcaktimi industrial	Formula kimike	Kodi tarifor	
Seksioni 1: Hidro klorofluorocarbonet e pasaturuara			
HFC-1234yf	CF ₃ CF = CH ₂	3824 78 00	4 Fn (2)
HFC-1234ze	trans — CHF = CHCF ₃	3824 78 00	7 Fn 2
HFC-1336mzz	CF ₃ CH = CHCF ₃	3824 78 00	9
HCFC-1233zd	C ₃ H ₂ ClF ₃	3824 78 00	4,5
HCFC-1233xf	C ₃ H ₂ ClF ₃	3824 78 00	1 Fn (3)
Seksioni 2: Eteret dhe alkoolet e fluorinuara			
HFE-125	CHF ₂ OCF ₃	3824 78 00	14 900
HFE-134 (HG-00)	CHF ₂ OCHF ₂	3824 78 00	6 320
HFE-143a	CH ₃ OCF ₃	3824 78 00	756
HCFE-235da2 (isofluorane)	CHF ₂ OCHClCF ₃	3824 78 00	350
HFE-245cb2	CH ₃ OCF ₂ CF ₃	3824 78 00	708
HFE-245fa2	CHF ₂ OCH ₂ CF ₃	3824 78 00	659
HFE-254cb2	CH ₃ OCF ₂ CHF ₂	3824 78 00	359
HFE-347 mcc3 (HFE-7000)	CH ₃ OCF ₂ CF ₂ CF ₃	3824 78 00	575
HFE-347pcf2	CHF ₂ CF ₂ OCH ₂ CF ₃	3824 78 00	580
HFE-356pcc3	CH ₃ OCF ₂ CF ₂ CHF ₂	3824 78 00	110
HFE-449sl (HFE-7100)	C ₄ F ₉ OCH ₃	3824 78 00	297
HFE-569sf2 (HFE-7200)	C ₄ F ₉ OC ₂ H ₅		59
HFE-43-10pccc124 (H-Galden 1040x) HG-11	CHF ₂ OCF ₂ OC ₂ F ₄ OCHF ₂	3824 78 00	1 870
HFE-236ca12 (HG-10)	CHF ₂ OCF ₂ OCHF ₂	3824 78 00	2 800
HFE-338pcc13 (HG-01)	CHF ₂ OCF ₂ CF ₂ OCHF ₂	3824 78 00	1 500
HFE-347mmy1	(CF ₃) ₂ CFOCH ₃	3824 78 00	343
2,2,3,3,3-pentafluoropropanol	CF ₃ CF ₂ CH ₂ OH	3824 78 00	42

bis(trifluoromethyl)-methanol	(CF ₃) ₂ CHOH	3824 78 00	195
HFE-227ea	CF ₃ CHFOCF ₃	3824 78 00	1 540
HFE-236ea2 (desfluoran)	CHF ₂ OCHF ₂ CF ₃	3824 78 00	989
HFE-236fa	CF ₃ CH ₂ OCF ₃	3824 78 00	487
HFE-245fa1	CHF ₂ CH ₂ OCF ₃	3824 78 00	286
HFE 263fb2	CF ₃ CH ₂ OCH ₃	3824 78 00	11
HFE-329 mcc2	CHF ₂ CF ₂ OCF ₂ CF ₃	3824 78 00	919
HFE-338 mcf2	CF ₃ CH ₂ OCF ₂ CF ₃	3824 78 00	552
HFE-338mmz1	(CF ₃) ₂ CHOCHF ₂	3824 78 00	380
HFE-347 mcf2	CHF ₂ CH ₂ OCF ₂ CF ₃	3824 78 00	374
HFE-356 mec3	CH ₃ OCF ₂ CHF ₂ CF ₃	3824 78 00	101
HFE-356mm1	(CF ₃) ₂ CHOCH ₃	3824 78 00	27
HFE-356pcf2	CHF ₂ CH ₂ OCF ₂ CHF ₂	3824 78 00	265
HFE-356pcf3	CHF ₂ OCH ₂ CF ₂ CHF ₂	3824 78 00	502
HFE 365 mcf3	CF ₃ CF ₂ CH ₂ OCH ₃	3824 78 00	11
HFE-374pc2	CHF ₂ CF ₂ OCH ₂ CH ₃	3824 78 00	557
	-(CF ₂) ₄ CH (OH)-	3824 78 00	73
Seksioni 3: Komponente të tjera të perfluorinuara			
perfluoropolymethylisopropyl-ether (PFPMIE)	CF ₃ OCF(CF ₃)CF ₂ OCF ₂ OCF ₃	3824 78 00	10 300
nitrogen trifluoride	NF ₃	3824 78 00	17 200
trifluoromethyl sulphur pentafluoride	SF ₅ CF ₃	3824 78 00	17 700
perfluorocyclopropane	c-C ₃ F ₆	3824 78 00	17 340Fn (4)

(1) Bazuar në raportin e vlerësimit të katërt të miratuar nga Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike, përveç nëse tregohet ndryshe.

(2) PNG sipas raportit të vlerësimit të 2010 të Panelit të Vlerësimit Shkencor (SAP) të Protokollit të Montrealit, tabelat 1-11, duke përmendur dy referenca shkencore - http://ozone.unep.org/Assessment_Panels/SAP/Scientific_Assessment_2010/index.shtml

(3) Vlera e parazgjedhur, potenciali I ngrohjes globale ende nuk është në dispozicion.

(4) Vlera minimale sipas Raportit të Vlerësimit të Katërt të miratuar nga Paneli Ndërqeveritar mbi Ndryshimet Klimatike

ANEKSI III NDALIMI I VENDOSJES NË TREG REFERUAR NË KREUN III (1.1)

Produktet dhe pajisjet		Data e ndalimit
Kur është e relevante, PNG i përzierjeve që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara do të llogaritet në përputhje me aneksin IV, siç parashikohet në pikën 4.6 të kreut I.		
1. Kontejnerë jorimbushës për gazet me efekt serrë të fluorinuara të përdorur për shërbim, mirëmbajtje ose mbushje të ftohëseve, ajrit të kondicionuar ose pajisjeve, pajisjet e pompave të nxehësive, sistemet e mbrojtjes nga zjarri ose switchgear, ose për përdorim si tretës.		
2. Sisteme të avullimit direkt jo-të mbyllur që përmbajnë HFC dhe PFCs si ftohës		
3. Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri	Që përmban PFCs	
	Që përmban HFC-23	
4. Dritare për përdorim shtëpiak që përmbajnë gaze me efekt serrë të fluorinuara.		
5. Dritare të tjera që përmbajnë gaze me efekt serrë të fluorinuara.		
6. Këpucë që përmbajnë gaze me efekt serrë të fluorinuara.		
7. Goma që përmbajnë gaze me efekt serrë të fluorinuara.		

8.Shkumë me një komponent, me përjashtim kur kërkohet për të përmbushur standardet kombëtare të sigurisë, që përmbajnë gaze serrë të fluorinuara me PNG prej 150 ose më shumë.	
9.Gjeneratorë të aerosoleve të tregtuar dhe të destinuar për shitje për publikun e përgjithshëm/gjerë për qëllime argëtuese dhe dekorative, siç listohen në pikën 40 të aneksit XVII të rregullores (EC) nr. 1907/2006, dhe briërë që lëshojnë sinjale, që përmbajnë HFC me një PNG prej 150 apo më shumë.	
10.Frigoriferët dhe ngrirësit shtëpiakë që përmbajnë HFC me një PNG prej 150 apo më shumë	
11.Frigoriferët dhe ngrirësit për përdorim komercial/tregtar (pajisje e mbyllur hermetikisht).	që përmbajnë HFCs me një PNG prej 2500 ose më shumë që përmbajnë HFCs me një PNG prej 150 ose më shumë
12.Pajisje e palëvizshme ftohëse, që përmban, apo funksionimi i së cilës mbështetet mbi, HFC me PNG prej 2 500 apo më shumë, përveç pajisjeve të destinuara dhe të projektuara për aplikim në ftohjen e produkteve në temperatura nën - 50 ° C	
13.Paketa e sistemeve të centralizuara të ftohjes për përdorim tregtar me një kapacitet të vlerësuar prej 40 kW ose më shumë që përmbajnë apo funksionimi i së cilës mbështetet mbi gazet serrë të fluorinuara me PNG prej 150 apo më shumë, përveç në qarqet primare të ftohjes të sistemeve të kaskadave ku gazet serrë të fluorinuara me një PNG prej më pak se 1 500 mund të përdoren.	
14.Pajisja e lëvizshme me ajër të kondicionuar e dhomës (pajisjet e mbyllura hermetikisht të cilat janë të lëvizshme mes dhomave nga ana e përdoruesit të fundit) që përmbajnë HFC me PNG prej 150 apo më shumë.	
15. Sistemet e veçanta të ndara të ajrit të kondicionuar që përmbajnë më pak se 3 kg të gazeve serrë të fluorinuara, që përmbajnë, apo funksionimi i të cilave mbështetet mbi gazet serrë të fluorinuara me PNG prej 750 ose më shumë.	
16.Shkumë që përmban HFC me një PNG prej 150 apo më shumë, përveç kur kërkohet për të përmbushur standardet kombëtare të sigurisë.	Polystyrene i ekstraktuar(XPS) Shkuma të tjera
17.Aerosole teknike që përmbajnë HFC me një PNG prej 150 apo më shumë, me përjashtim kur kërkohet për të përmbushur standardet e sigurisë kombëtare apo kur përdoret për përdorim mjekësor.	

ANEKSI IV METODA E KALKULIMIT TOTAL TË PNG PËR PËRZIERJET

PNG e një përzierje është llogaritur si një mesatare e ponderuar, që rrjedh nga shuma e fraksioneve të peshës së substancave të veçanta shumëzuar me PNG e tyre, nëse nuk specifikohet ndryshe, duke përfshirë edhe substancat që nuk janë gaze serrë të fluorinuara.

Ku % është kontributi i peshës me një tolerancë të peshës +/- 1%.

Për shembull: duke aplikuar formulën për një përzierje të gazeve të përbërë nga 60% eter dimetil, 10% HFC-152a dhe 30% izobutani:

→ Totali PNG = 13,9

PNG e substancave të mëposhtme jo të fluorinuara është përdorur për të llogaritur PNG e përzierjeve. Për substancat e tjera jo të listuara në këtë aneks zbatohet një vlerë e parazgjedhur e 0.

Substanca			PNG
Emri i përgjithshëm	Përcaktim industrial	Formula kimike	
methane		CH ₄	25
nitrous oxide		N ₂ O	298
dimethyl ether		CH ₃ OCH ₃	1
methylene chloride		CH ₂ Cl ₂	9
methyl chloride		CH ₃ Cl	13
chloroform		CHCl ₃	31
ethane	R-170	CH ₃ CH ₃	6
propane	R-290	CH ₃ CH ₂ CH ₃	3
butane	R-600	CH ₃ CH ₂ CH ₂ CH ₃	4

isobutane	R-600a	CH(CH ₃) ₂ CH ₃	3
pentane	R-601	CH ₃ CH ₂ CH ₂ CH ₂ CH ₃	5 (2)
isopentane	R-601a	(CH ₃) ₂ CHCH ₂ CH ₃	5 (2)
ethoxyethane (diethyl ether)	R-610	CH ₃ CH ₂ OCH ₂ CH ₃	4
methyl formate	R-611	HCOOCH ₃	25
hydrogen	R-702	H ₂	6
ammonia	R-717	NH ₃	0
ethylene	R-1150	C ₂ H ₄	4
propylene	R-1270	C ₃ H ₆	2
cyclopentane		C ₅ H ₁₀	5 (2)

(1) Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Katërt të miratuar nga Paneli Ndërqeveritar mbi Ndryshimet Klimatike, përveç nëse tregohet ndryshe.

(2) Substancë jo e listuar në Raportin e Vlerësimit të Katërt të miratuar nga Paneli Ndërqeveritar mbi Ndryshimet Klimatike, vlerë e paracaktuar në bazë të PNGs e hidrokarbureve të tjera.

ANEKSI V TË DHËNAT PËR TËU RAPORTUAR NË PËRPUTHJE ME KREUN IV

1. Çdo prodhues referuar kreut IV (1.1) duhet të raportojë, për:

a) sasinë totale të çdo substance të listuar në anekset I dhe II që ai ka prodhuar në RSH, identifikimin kategorive kryesore të përdorimit në të cilën substanca përdoret;

b) sasinë e çdo substance të listuar në aneksin I dhe, kur është e zbatueshme, aneksin II që ka vendosur në tregun e Bashkimit Evropian, duke specifikuar në mënyrë të ndarë sasitë e vendosura në treg për përdorime të *feedstock*, eksportet e drejtpërdrejta, duke prodhuar doza të matura të inhalatorëve për shpërndarjen e përbërësve farmaceutikë, përdorimit në pajisje ushtarake dhe përdorimin në gravurën e materialit gjysmëpërçues apo pastrimin me avull kimik të depozitimit të dhomave brenda sektorit të prodhimit gjysmëpërçues;

c) sasitë e çdo substance të listuar në anekset I dhe II, të cilat janë ricikluar, rigjeneruar dhe shkatërruar, respektivisht;

ç) çdo rezervë të mbajtur në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit.

2. Çdo importues referuar kreut IV (1.1), duhet të raportojë për:

a) sasinë e çdo substance të listuar në aneksin I dhe, kur është e zbatueshme, aneksin II që ka importuar në Bashkimin Evropian, identifikimin e kategorive kryesore të përdorimit në të cilën substanca përdoret, duke specifikuar në mënyrë të ndarë sasitë të vendosura në treg për shkatërrim, për përdorim *feedstock*, eksportet e drejtpërdrejta, duke prodhuar duke prodhuar doza të matura të inhalatorëve për shpërndarjen e përbërësve farmaceutikë, përdorimit në pajisje ushtarake dhe përdorimin në gravurën e materialit gjysmëpërçues apo pastrimin me avull kimik të depozitimit të dhomave brenda sektorit të prodhimit gjysmëpërçues;

b) sasitë e çdo substance të listuar në anekset I dhe II, të cilat janë ricikluar, rigjeneruar dhe shkatërruar, respektivisht;

c) çdo rezervë e mbajtur në fillim dhe në fund të periudhës raportuese.

3. Çdo eksportues referuar kreut IV (1.1), duhet të raportojë për:

a) sasitë e çdo substance të listuar në anekset I dhe II, që ka eksportuar nga RSH-ja, përveç riciklimit, rigjërimit ose shkatërrimit;

b) çdo sasi e çdo substance të listuar në anekset I dhe II, që ka eksportuar nga RSH-ja për t'u ricikluar, rigjeneruar dhe shkatërruar, respektivisht.

4. Çdo sipërmarrje e përmendur në kreun IV (1.2) do të raportojë për:

a) sasitë e çdo substance të listuar në anekset I dhe II të shkatërruar, duke përfshirë edhe sasinë e atyre substancave që gjenden në produkte ose pajisje;

b) çdo rezervë e çdo substance të listuar në anekset I dhe II në pritje për t'u shkatërruar, duke përfshirë edhe sasinë e atyre substancave që gjenden në produkte ose pajisje;

c) teknologjinë e përdorur për shkatërrimin e substancave të listuara në anekset I dhe II.

5. Çdo sipërmarrje e përmendur në kreun IV (1.3), duhet të raportojë për sasitë e çdo substance të

listuar në aneksin I të përdorur si *feedstock*.

6. Çdo sipërmarrje e përmendur në kreun IV (1.4), duhet të raportojë për:

- a) kategoritë e produkteve ose të pajisjeve që përmbajnë substanca të listuara në anekset I dhe II;
- b) numrin e njërive;
- c) çdo sasi të çdo substance të listuar në anekset I dhe II të përfshira në produktet ose pajisjet.

ANEKS VI

SHPESHTËSIA E KONTROLLIT TË PAJISJEVE REFERUAR PIKËS 2.4 TË KREUT II

CO ₂ eq në tonë	Shpeshtësia e kontrollit (numri max i muajve midis kontrolleve)	
	pa LDS ²	Me LDS të instaluar
5-50	12	24
51-500	6	12
500+	3	6

²LDS- (Leakage Detection System) - Sistemi i Zbulimit të Rrjedhjeve

